

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8691, DATË 16.11.2000 “PËR PRODHIMIN DHE TREGTIMIN E DUHANIT DHE TË CIGAREVE”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është ndryshimi i disa neneve apo pikave të veçanta të neneve të ligjit nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, të ndryshuar. Ky projektligj është hartuar pas konsultave me grupet e interesit kryesisht: Agjencinë Kombëtare të Duhan-Cigareve, si Institucioni përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve, Entin Shtetëror të Farave e Fidanëve, Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, Shoqatën e Fermerëve “Dumreja” në Elbasan, Kompaninë grumbulluese dhe përpunuese “Seke” sha Elbasan, subjekteve “Philip Morris Albania”, “Japan Tabacco International”, “British American Tabacco”, “Aгна Group”, “M&D”, “Sheldia-grup”, “Iгла” shpk, “Besnik Isufaj & Shelqeti Company” fermerë, importues dhe eksportues të duhanit dhe produkteve të tij, bazuar në kriteret e përcaktuara në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Subjektet importuese “Philip Morris Albania”, “Japan Tabacco International”, “British American Tabacco”, “Aгна Group”, “M&D” kanë bërë porpozimet për: përshtajen dhe shtimin e përkufizimve, rregullimin ligjor për produktet e reja që vendosen në treg, heqja e komisionit të degustimit shijor të cigareve, me përjashtim të markave të reja që vendosen për herë të parë në treg, dhe kryerja e analizave në përputhje me standartet ISO të cialt janë marrë në konsideratë dhe janë pasqyruar në draft (neni 1, pika 2 e nenit 7, neni 8, pika 3 e nenit 7).

Shoqata “Dumreja” e kultivuesve dhe prodhuesve të duhanit në Elbasan, si përfaqësuese e prodhuesve të duhanit në këtë qark, nisur nga problemet që ka patur me subjektin “Mika Korca”, ka paraqitur kërkesat e saj për nevojën e rregullimit të marrëdhënjëve kontraktuale ndërmjet fermerëve dhe kompanive grumbullues-përpunuese, (pika 1 e nenit 8 të projekt ligjit) problemet që lindin me dorëzimin e duhanit dhe veçanërisht me vlerësimin e cilësisë dhe çmimin e tij si dhe shlyerjen e vlerës së prodhimit të kontraktuar, garancinë bankare në masën 100% të vlerës së duhanit të grumbulluar, pajisjen e fermerëve me dokumentacion nga ana e grumbullues-përpunuesit për prodhimin e duhanit që mbahet në ruajtje në ambientet e grumbullues-përpunuesit dhe shlyerjen e detyrimit financiar jo më vonë se 30 ditë nga dita e blerjes së

duhanit. Këto kërkesa të shoqatës së fermerëve janë marrë parasysh dhe janë reflektuar në projektligj.

Grumbullues-përpunuesi “Seke” shpk ka kërkuar që garanica e kontratave (draft ligji shkronja “d”, pika 4 e nenit 4) të mundësohet edhe nëpërmjet linjave të finacimit me institucionet finaciare në vend. Po kështu ata kërkojnë që komisioni i rivlerësimit të duhanit të përbëhet në raporte të barabarta mes palëve nga prodhuesi i duhanit (ose përfaqësuesi i tij), përfaqësuesi i grumbullues-përpunuesit dhe përfaqësuesi i Institucionit përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve, (pasqyruar në pikën 6 të nenit 4). Edhe kërkesa që fermentimi artificial të mos jetë detyrim ligjor për eksport është marrë parasysh dhe pasqyruar në nenin 8 të projekt ligjit.

Grumbullues-përpunuesi “Mika Korça”, ka kërkuar sqarim për kartelën personale, garancinë bankare, dokumentet kur duhani mbahet në ruajtje duke mos i pranuar këto me pretendimin se bie ndesh me kushtetutën. Nga këto kërkesa është marrë në konsideratë lidhja e kontratës bazuar në nenin 686 të Kodit Civil dhe janë bërë ndryshimet e nevojshme në projektligj (neni 5 pika 1). Kërkesa për të mos patur si detyrim garancinë bankare në masën 30%, nuk është marrë parasysh pasi argumentet që sjell kompania lidhur me dhënien falas të materialeve si farë duhani, spango, rrjetë hije, makineri të shkuarjes varg të duhanit e tjera nuk justifikojnë arsyetimin e vendosjes së fondit të garancisë në masën 30% (në draft është propozuar 100%). Përveç kësaj kompania “Mika Korça” nuk ka qenë korrekte në zbatimin kërkesave të kontratave të lidhura me pagesat e vlerës së duhanit të grumbulluar.

Projektligji përcakton rregulla më të qarta për prodhimin, grumbullimin, përpunimin, standardizimin si dhe tregtimin e duhanit dhe produkteve të tij.

Gjithashtu në këtë projektligj janë përcaktuar rregulla të reja për kontrollin e produkteve të duhanit të pranishme në tregun shqiptar, kundërvajtjet administrative dhe sanksionet për këto kundërvajtje si dhe janë bërë përmirësime të rëndësishme për disa tarifa për sanksionet që vendosen nga inspektorati i AKU-së.

Në pikën 1/1 të nenit 3 të këtij projektligji është përcaktuar se njësia përgjegjëse për bujqësinë në qarqe pajisin prodhuesin e duhanit me ***kartelën personale të verifikuar*** për të dhënat faktike, mbi bazën e deklaratës së fermerit, vetëm pasi të jetë nënshkruar kontrata me një grumbullues-përpunues të licencuar. Shkelja e kësaj kërkesë të rëndësishme është konsideruar kundërvajtje. Po kështu është përcaktuar si kundërvajtje administrative edhe shkelja e kërkesave të pikës 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 4, të këtij ligji pasi nuk kanë qenë përcaktuar si të tilla në ligjin e mëparshëm dhe i konsiderojmë të rëndësishme për zbatimin e rregullave të prodhimit dhe grumbullimit të duhanit nga subjektet sipas kërkesave të standardeve shtetërore në fuqi. Përcaktimet e nenit 5 të këtij projektligji për lidhjen e kontratës me shkrim (pika 1 e nenit 5) dhe shlyerja e detyrimit financiarë brenda 30 ditëve (pika 4 e nenit 5), janë konsideruar kundërvajtje administrative pasi fryma e këtij projektligji e konsideron të rëndësishme dhe

detyruese lidhjen e kontratës mes prodhuesit dhe grumbullues-përpunuesit si dhe detyrimin që subjektet grumbulluese të shlyejnë detyrimin financiarë jo më vonë se 30 ditë nga data e faturës financiare, sipas kontratës. Të njëjtat shpjegime vlejné edhe përcaktimet e tjera në nenin 10 të këtij projektligji, me arsyetimin se ligji i amenduar ka boshllëqe dhe lenë hapësira për abuzime si dhe për faktin tjetër që nëpërmjet këtij projektligji formalizohet prodhimi, grumbullim-përpunimi dhe tregtimi i duhanit dhe produkteve të tij.

Nivelin e gjobave të vendosura në këtë projektligj, është menduar se shkon në raporte me dëmin e shkaktuar nga kundravajtësit ndaj interesit publik dhe atij privat për rastet e shkeljes së ligjit.

Ky projekt ligj synon të arrijë këto objektiva:

1. Përmirësimi i kuadrit ligjor për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe produkteve të tij, me synim rritjen e formaliteti, luftën ndaj produkteve ilegale, që nuk paguajnë taksa dhe shtimin e të ardhurave në buxhetin e shtetit.
2. Përcaktimin bashkëkohor të përkufizimeve.
3. Përmirësimin ligjor të marrëdhënieve të ndërsjella mes grumbullues-përpunuesit dhe fermerit prodhues, marrëdhënie të cilat mbi bazën e këtij ligji do të rregullohen me kontratë të shkruar, individuale ose kolektive.
4. Pajisja e çdo fermeri në rolin e prodhuesit të duhanit me kartelën personale të konfirmuar zyrtarisht nga njësia përgjegjëse për bujqësinë në qarqe.
5. Vlerësimin cilësor të duhanit sipas standardeve shtetërore në fuqi dhe produkteve të tij vetëm sipas standarteve ISO. Ligji zgjidh konfliktin mes fermerëve prodhues dhe grumbullues-përpunuesve lidhur me sezonin e grumbullimit të duhanit, duke përfshirë detyrimin ligjor për përgatitjen e mostrave para fillimit të sezonit, demonstrimin e tyre në çdo pikë të grumbullimit sipas tipeve të duhanit, klasave e cilësive të përcaktuara në standardet shtetërore, paraqitjen zyrtarisht në Institucionin përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve, të kopjes të kontratës së lidhur mes palëve në fillim të sezonit të prodhimit, grafikut të grumbullimit, listën e pikave të grumbullimit, vendndodhjen e tyre, garancinë bankare për shlyrjen e 100 % të vlerës së prodhimit të kontraktuar dhe mbi këtë bazë merr miratimin nga, Institucioni përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve,
6. për fillimin e grumbullimit, rregullat e rivlerësimit si dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve që lindin midis palëve.
7. Përcaktimin e kundërvajtjeve administrative dhe të sanksioneve që jepen nga inspektoriati i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në rast shkeljesh të rregullave të kultivimit ,të grumbullimit të prodhimit dhe

tregtimit të duhanit dhe produkteve të tij, duke përcaktuar masë fikse për çdo kundërvajtje, me arsyetimin për ti prerë rrugën abuzimeve të mundshme në vendosjen e gjobave. Në këtë projektligj janë shtuar kundërvajtjet administrative për t'ju përgjigjur ndryshimeve të neneve të ligjit si dhe për faktin se në praktikën e përditshme të zbatimit të ligjit 8691 datë 16.11.2000 ka pasur boshllëqe dhe mospërputhje mes kërkesave të grumbullues-përpunuesve dhe prodhuesve të duhanit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Përgatitja e këtij projektligji nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është bazuar në angazhimin që ka ministria për tu ardhur në ndihmë fermerëve për zgjidhjen e kërkesave të vazhdueshme të tyre për liberalizimin e tregut të grumbullim-përpunimit të duhanit në funksion të shtimit të sipërfaqes së mbjellë me këtë bimë, lehtësimin e procedurave për tregtimin e duhanit të manipuluar nga fermerët prodhues, shtimin e operatorëve të tjerë për grumbullim-përpunimin e duhanit, si dhe rregullimin ligjor të marrëdhënieve prodhues dhe grumbullues-përpunues.

Gjithashtu ky projektligj synon përmirësimin e kuadrit ligjor për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe produkteve të tij, me synim rritjen e formalitetit, luftën ndaj produkteve ilegale, që nuk paguajnë taksa dhe shtimin e të ardhurave në buxhetin e shtetit.

Ky projektligj është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Me këtë projektligj Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, synon të bëjë disa përmirësime të nevojshme në funksion të kërkesave të fermerëve që prodhojnë duhan, shtimin e konkurrencës në tregun e grumbullimit-përpunimit të duhanit si dhe krijimin e mundësisë për rritjen e eksportit.

Projektligji përcakton se fermerët duhet të pajisen me kartelë personale nga njësia përgjegjëse për bujqësinë, bazuar në deklaratën e fermerit, për vendin, sipërfaqen, tipin, llojin dhe prodhimin e pritshëm të duhanit. Kushti që kartela personale i jepet fermerit vetën pas paraqitjes së kontratës me grumbullues-përpunues të licencuar, synon të garantojë formalizmin e prodhimit të duhanit dhe shitjen e tij në treg, pasi ka prodhues informal të cilët prodhimin e tyre e destinojnë si duhan të grirë në treg. Çdo fermer do të lejohet të mbjellë fidana

duhani të prodhuara vetëm nga farat e certifikuara sipas përcaktimit të ligjit nr. 10416 datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, të ndryshuar.

Me këtë projektligj sigurohet që fermerët që prodhojnë duhan dhe grumbullues-përpunuesi i rregullojnë marrëdhëniet midis tyre përmes lidhjes së kontratës së shkruar. Prodhimi dhe grumbullimi i duhanit kryhet sipas standardeve shtetërore dhe ISO. Në këtë projektligj është përcaktuar afati i fillimit dhe përfundimit të grumbullimit të duhanit nga 1 nëntori deri në 31 mars të vitit pasardhës. Në projektligj është përcaktuar statusi i Institucionit përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve, detyrimet që ka grumbullues-përpunuesi ndaj, Institucionit përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve, monitorimi i mostrave të duhanit mbi të cilat bëhet vlerësimi i cilësisë së tij midis palëve kontraktuale si dhe rrugët e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mes prodhuesve dhe kompanive grumbullues-përpunuese për cilësinë e duhanit.

Projektligji i hap rrugë formalizimit të produkteve të reja në treg që aktualisht janë të vendosura por nuk janë plotësisht të rregulluara me ligj.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Miratimi i këtij projektligji krijon lehtësira për fermerët e vendit tonë që prodhojnë duhan, detyrimin e grumbullues-përpunuese për të zbatuar standardet shtetërore në fuqi, shtimin e konkurrencës në tregun e grumbullimi-përpunimit dhe rritjen e eksportit të duhanit dhe produkteve të tij.

Projektligji është përgatitur në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Nuk ka përafrim me direktivat e BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përmban 15 nene.

Në nenin e parë, përkufizohen produktet e duhanit të cilat tregtohen në vendin tonë.

Në nenin e dytë, rregullohet emërtimi duke zëvendësuar emërtimet “Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit” dhe “Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve”, do të zëvendësohen përkatësisht me emërtimin “Ministria përgjegjëse për bujqësinë” dhe “Institucioni përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve”, si dhe fjala

“Grumbullues” do të zëvendësohet me fjalët “Grumbullues-Përpunues”.

Në nenin e tretë, përcaktohet që çdo fermer që prodhon duhan mbi bazën e vetëdeklarimit në njësinë përgjegjëse për bujqësinë në qark pajiset me “*kartelën personale të verifikuar*”, modeli i së cilës hartohet nga Institucioni përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve dhe miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për bujqësinë. Kartela personale do të përmbajë të dhëna për emrin e fermerit, NIPT-in, sipërfaqen e mbjellë, emrin e subjektit grumbullues-përpunues, numrin e kontratës së lidhur me subjektin grumbullues-përpunues, prodhimin e pritshëm për tipet dhe llojet e duhaneve të mbjella.

Në nenin e katërt, përcaktohen rregullat e grumbullimit të duhanit nga grumbullues-përpunuesi konform standardeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë si dhe përcaktohet sezoni i grumbullimit, detyrimin për të demonstruar mostrat përfaqësuese për çdo tip/grup duhani, sipas kërkesave të standardeve shtetërore në fuqi, detyrimet e grumbulluesit ndaj Institucionit përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve për të paraqitur grafikët e grumbullimit, listën e pikave të grumbullimit dhe vendndodhjen e tyre, dokumentin e garancisë nga institucionet finaciare për 100% të vlerës së prodhimit të kontraktuar si dhe mënyra e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Në pikën 6 të këtij neni përshkruhen kriteret e vlerësimit të cilësisë së duhanit në qendrat e grumbullim-përpunimit bazuar në mostrat përfaqësuese dhe standardeve shtetërore në fuqi. Gjithashtu në këtë nen përcaktohen rrugët e zgjidhjes të kundërshtimeve mes palëve lidhur me vlerësimin e cilësisë dhe sasisë së prodhimit të duhanit nga komisioni i ekspertëve, i cili duhet të përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë, me përfaqsim të barabartë palëve si dhe një përfaqësues ekspert i fushës i Institucionit përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve. Në pikën 7 të këtij neni është përcaktuar se kundër vlerësimit të komisionit mund të bëhet ankimim në gjykatën administrative brënda 30 ditëve. Në pikën 8 të këtij neni përcaktohet se përbërja detyrat dhe funksionet e komisionit të eksperteve të rivlerësimit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për bujqësinë.

Në nenin e pestë, rregullohen kërkesat e nenit 11 të ligjit nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, të ndryshuar, duke përcaktuar në rrugë ligjore marrëdhëniet midis fermerëve në rolin e prodhuesit dhe grumbullues-përpunuesit të duhanit nëpërmjet lidhjes së kontratës. Në pikën 4 të këtij neni përcaktohet se koha e shlyerjes së detyrimit financiar të fermerëve nga ana e grumbullues-përpunuesit është 30 ditë nga data e faturës së blerjes së duhanit. Për rastet kur grumbullues-përpunuesi nuk respekton afatin për pagesën e faturës të nënshkruar nga dy palët, prodhuesi kërkon nga institucioni financiar ekzekutimin e garancisë për shlyerjen e detyrimit.

Në nenin e gjashtë, rregullohen kërkesat e nenit 12 të ligjit, nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, të ndryshuar, duke krijuar mundësinë që prodhimi i duhanit mund të tregtohet përveçse me “dengje fshati” edhe me “kuti kartoni”, me përjashtim të duhaneve të tipit gjethemëdhenj, të cilat grumbullohen direkt pas vjeljes.

Në nenin e shtatë, rregullohen kërkesat e nenit 15 të ligjit, nr. 8691, datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve”, të ndryshuar, duke përcaktuar detyrimin që kanë prodhuesit dhe importuesit e produkteve të duhanit për të regjistruar markat e këtyre produkteve në Regjistrin e Markave pranë Institucionit përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve. kryerjen e analizave fiziko kimike dhe vlerësimin cilësor të markave e cigareve sipas standartit ISO vetëm njëherë në vit sipas kërkesave të biznesit .

Në nenin e tetë, rregullohen kërkesat e nenit 16 duke përcaktuar që duhanet në vendin tonë tregtohen i përpunuar dhe i manipuluar, në dengje industriale, i fermentuar ose jo, sipas cilësive dhe klasave.

Në nenin e nëntë, rregullohen kërkesat e neni 21, duke përcaktuar statusin e Institucionit përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve.

Në pikën 2 të këtij neni përcaktohet se organizimi dhe funksionimi dhe detyrat e këtij institucioni miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, duke mbajtur parasysh kërkesat e nenit 6 dhe nenit 21 të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore, kërkesat e ligjit nr. 153/2013 “Për nëpunësin civil” si dhe Kodin e Punës për pjesën e punonjësve që nuk përfshihen në kategorinë e nëpunësve civil.

Në nenin e dhjetë, rregullohet kërkesat e nenit 22 duke përcaktuar kundërvajtjet administrative kur ato nuk përbëjnë vepër penale. Nga praktika e deritanishme e zbatimit të ligjit 8691 datë 16.11.2000 “Për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe të cigareve” të ndryshuar ka rezultuar se ka nene të këtij ligji moszbatimi i të cilave, ndonëse përbën kundravajtje administrative nuk është e sanksionuar në ligj. Këto ndryshime krijojnë mundësi dhe lehtësira institucioneve kontrolluese dhe atyre të fiskut për formalizimin e tregut të duhanit dhe zbatimin e ligjshmërisë për prodhimin dhe tregtimin e duhanit dhe produkteve të tij.

Në nenin njëmbëdhjetë, riformulohet neni 22, pika c/1, duke qënë se neni 19/a shfuqizohet ky parashikim reflektohet edhe në këtë pikë.

Në nenin dymbëdhjetë, përcaktohen ndëshkimet dhe masën e gjobës që duhet të aplikojnë inspektorët e AKU-së sipas përcaktimit të nenit 10 për kundërvajtjet administrative. Me këtë nen bëhet e mundur që në rast të kundërvajtjeve

administrative sanksionet të jenë fikse, të justifikuara dhe mos të lënë shteg abuzimeve në vendosjen e gjobave.

Në nenin trembëdhjetë, shfuqizohen nenet 17, 18, 19 dhe 20 të ligjit në fuqi pasi ato janë të rregulluara me ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produkte e duhanit”.

Në nenin katërbëdhjetë, përcaktohet nxjerrja akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave përkatësisht për kërkesat ligjore në nenin 15, pika 4, si dhe nga ministri përgjegjës për bujqësinë, për kërkesat ligjore në nenet të nenit 9, pika 1/1, nenit 10, pika 8 dhe nenit 15, pika 3.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Duhan Cigareve i cili është Institucioni përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve, Autoriteti Kombëtarë i Ushqimit dhe Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Institucionin përgjegjës që mbulon fushën e duhan-cigareve, (AKDC-në), Autoritetin Kombëtar të Ushqimit dhe grupet e interesit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projekt-ligj nuk ka efekte financiare.

MINISTRI

Niko Peleshi